



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 10 qershor 2013
Nr. ref.:RK422/13

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KI22/13

parashtrues

Sokol Mushkolaj

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme , Pkl. nr. 164/2012, të 5 dhjetorit 2012; të Vendimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, Ap. nr. 4/12, të 28 shtatorit 2012; të Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Prishtinë, P. nr. 601/08, të 3 tetorit 2011; dhe të Vendimit të Gjykatës Komunale në Prishtinë, P. nr. 601/08, të 20 dhjetorit 2011

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është Sokol Mushkolaj, avokat, me vendbanim në Fushë-Kosovë.

Vendimet e kontestuara

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, Pkl. nr. 164/2012, të 5 dhjetorit 2012; Vendimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, Ap. nr. 4/12, të 28 dhjetorit 2012; Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prishtinë, P. nr. 601/08, të 3 tetorit 2011; dhe Vendimin e Gjykatës Komunale në Prishtinë, P. nr. 601/08, të 20 dhjetorit 2011.

Baza juridike

3. Neni 113.7 dhe neni 116.2, të Kushtetutës; nenet: 20, 22.7, 22.8 dhe 27, të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121, të 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejme: Ligji); dhe rregulli 56 (2) i Rregullores së punës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes së kërkesës është ankesa e parashtruesit të kërkesës se gjykatat e rregullta e kanë dënuar atë me gjashtë muaj burg, duke aplikuar gabimisht nenin 90.6 të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (në tekstin e mëtejme: KPPK), që ka të bëjë me parashkrimin absolut të ndjekjes penale, si dhe nenet: 124, 125 dhe 126, të Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës (në tekstin e mëtejme: KPPPK), që ka të bëjë me dorëzimin e dokumenteve gjyqësore.
5. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu kërkon nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata) që, në bazë të nenit 116.2 të Kushtetutës, të vendosë Masën e përkohshme dhe të pezullojë Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prishtinë, P. nr. 601/2008, të 3 tetorit 2011, si dhe të pezullojë përmbarimin e dënimit me burg, deri në përfundimin e kësaj çështjeje juridiko-penale.
6. Gjithashtu, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që të mos i zbulohet identiteti.

Procedura në Gjykatë

7. Më 25 shkurt 2013, parashtruesi i parashtroi kërkesë Gjykatës.
8. Më 28 shkurt 2013, Kryetari caktoi gjyqtarin Robert Carolan Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, në përbërje të gjyqtarëve: Snezhana Botusharova (kryesuese), Kadri Kryeziu dhe Arta Rama-Hajrizi (anëtarë).

9. Më 12 mars 2013, Gjykata njoftoi parashtruesin e kërkesës dhe Gjykatën Supreme të Kosovës për regjistrimin e kërkesës në regjistrin përkatës të Gjykatës.
10. Më 13 mars 2013, Gjykata kërkoi dokumente shtesë nga Gjykata Komunale në Prishtinë dhe nga parashtruesi i kërkesës.
11. Më 19 dhe 21 mars 2013, parashtruesi dhe Gjykata Komunale në Prishtinë u përgjigjën në kërkesën e Gjykatës.
12. Më 29 prill 2013, Kryetari caktoi gjyqtarin Ivan Čukalović Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, në përbërje të gjyqtarëve: Snezhana Botusharova (kryesuese), Kadri Kryeziu dhe Enver Hasani (anëtarë).
13. Më 13 maj 2013, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve të dëshmuara me dokumentet e ofruara nga parashtruesi i kërkesës

14. Më 3 tetor 2011, Gjykata Komunale në Prishtinë, me Aktgjykimin P. nr. 601/08, gjeti se parashtruesi i kërkesës kishte kryer vepër penale mashtrimi nga neni 261, par. 1, i KPPK-së, prandaj i shqiptoi dënim me burg, të cilin parashtruesi i kërkesës do ta mbajë pasi Aktgjykimi të marrë formën e prerë.
15. Në dispozitivin e Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Prishtinë, P. nr. 601/08, thuhej:

“ ...

AKTGJYKIM

I pandehuri, SOKOL MUSHKOLAJ nga babai H. dhe nëna B. e gjinisë H., i lindur me 19.12.1952 ne Deçan, rruga ‘Dëshmorët e Kombit’ nr. 86, ku edhe tani jeton, ka të kryer fakultetin juridik, me profesion avokat në Deçan, i martuar baba i një fëmijë, i gjendjes së mesme ekonomike, i pa gjykuar, kundër tij nuk zhvillohet procedurë për vepër tjetër penale.

ËSHTË FAJTOR

Sepse me qëllim që vetit t’i sjellë dobi pasurore të kundërligjshme, me fshehjen e fakteve i pandehuri Sokol Mushkolaj më dt. 23.11.2006 në Prishtinë, në zyrën e tij të avokatisë nga të dëmtuarit N. H. dhe N. H. ka marrë shumën e të hollave prej 500 euro, dhe në vazhdimësi më dt. 25.11.2006 nga të njëjtit ka marrë shumën e të hollave prej 2.000 euro, ku i pandehuri Sokol Mushkolaj, duke i vënë në lajthim dhe duke u premtuar se do të ndikoj në vendimin e Gjykatës së Qarkut të Prizrenit dhe Gjykatës Supreme të Kosovës, e cila gjykatë kishte shqiptuar dënim me 20 vjet burgim, duke u thënë se këtë dënim do t’ia zbret deri në 10 ose 13 vjet burg, dhe prapë gjatë muajit prill të vitit 2007 në një restorant në Pejë, nga të dëmtuarit N. H. dhe N. H., i pandehuri duke iu dhënë të njëjtat premtime si të lartcekurat ka marrë nga të dëmtuarit N. H. dhe N. H., shumën e të

hollave prej 3.000 euro, dhe nga ajo ditë të dëmtuarve të lartcekur nuk iu ka kthyer paratë.

Me këtë ka kryer vepër penale mashtrimi nga neni 261 par. 1 i KPK.

Prandaj, Gjykata në bazë të neneve 3, 34, 38, 64 dhe nenit 261 par. 1 i KPK, si dhe nenit 391 të KPK,

GJYKON

Me dënim burgu në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj të cilin do ta mbaj pasi që Aktgjykimi të merr formën e prerë.

...”

16. Më 20 dhjetor 2011, Gjykata Komunale në Prishtinë, me Vendimin P. nr. 601/08, refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës ndaj Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Prishtinë, P. nr. 601/08, si të paafatshme.
17. Më 28 shtator 2012, Gjykata e Qarkut në Prishtinë, me Vendimin Ap. nr. 4/12, refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës ndaj Vendimit të Gjykatës Komunale në Prishtinë, P. nr. 601/08, të 20 dhjetorit 2011.
18. Më 5 dhjetor 2012, Gjykata Supreme e Kosovës, me Aktgjykimin Pkl. nr. 164/2012, hodhi poshtë si të pabazuar kërkesën e parashtruesit të kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë kundër Vendimit të Gjykatës Komunale në Prishtinë, P. nr. 601/08, të 20 dhjetorit 2011, dhe kundër Vendimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, Ap. nr. 4/12, të 28 shtatorit 2012.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

19. Parashtruesi i kërkesës pretendon se ndjekja penale ndaj tij do të duhej të kishte përfunduar për shkak të parashkrimit të paraparë me nenin 90.6 të KPPK-së. Pretendon, gjithashtu, se gjykatat e rregullta kanë aplikuar gabimisht nenin 90.6 të KPPK-së, në dëm të tij.
20. Parashtruesi i kërkesës pretendon se gjykatat e rregullta nuk ia kishin dorëzuar vendimin atij personalisht, siç parashihet me nenet: 124, 125 dhe 126, të KPPK-së. Pretendon se gjykatat e rregullta kanë vepruar në shkelje të neneve: 124, 125 dhe 126, të KPPK-së, në dëm të tij.
21. Parashtruesi i kërkesës pohon shkeljen e nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe të nenit 33 [Parimi i Legalitetit dhe Proporcionalitetit në Rastet Penale] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 [E Drejta për një Proces të Rregullt] të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.
22. Parashtruesi i kërkesës propozon vendosjen e Masës së përkohshme për suspendim të përkohshëm të përmbarrimit të Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Prishtinë, P. nr. 601/08, të 3 tetorit 2011, në bazë të nenit 116.2 të Kushtetutës.

Ligji

“ ...

Mashtrimi

Neni 261

- (1) *Kushdo që me qëllim për t'i sjellë vetes apo personit tjetër ndonjë dobi pasurore e mashtron ose e sjell personin tjetër në lajthim me anë të paraqitjes së rreme apo duke i fshehur faktet dhe me këtë e shtyt personin e tillë që të veprojë apo të mosveprojë në dëm të pasurisë së tij ose të pasurisë së ndonjë personi tjetër, dënohet me gjobë apo me burgim deri në tri vjet.*

Parashkrimi i ndjekjes penale

Neni 90

- (1) *Me përjashtim të rasteve kur është paraparë ndryshe me këtë Kod, ndjekja penale nuk mund të ndërmerret nëse nuk kanë kaluar afatet e mëposhtme:*
- 6) *Dy vjet nga kryerja e veprës penale të dënueshme me më shumë se një vit burgim ose dënim me gjobë.*
- ...”

Vlerësimi i pranueshmërisë

23. Për të qenë në gjendje të shqyrtojë kërkesën e parashtruesit, Gjykata duhet së pari të vlerësojë nëse parashtruesi i kërkesës ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, me Ligj dhe me Rregullore të punës.
24. Në rastin konkret, Gjykata vëren se Gjykata Komunale në Prishtinë gjeti fajtor për mashtrim parashtruesin e kërkesës dhe e dënoi atë me gjashtë muaj burgim. Më pastaj, ky dënim u konfirmua nga po e njëjta gjykatë, nga Gjykata e Qarkut në Prishtinë dhe nga Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës.
25. Gjykata vëren se gjykatat e rregullta zgjodhën që t'i shqiptojnë parashtruesit të kërkesës dënim më të vogël sesa është paraparë me ligj, duke argumentuar se parashtruesi i kërkesës është në moshë relativisht të shtyrë. Fakti se ai nuk ishte dënuar më parë dhe faktorë të tjerë shërbyen si rrethana lehtësuese në dobi të tij.
26. Sa i përket pretendimeve të parashtruesit të kërkesës se ai është gjykuar përtej parashkrimit, ose se nuk i ishte dorëzuar vendimi atij personalisht, Gjykata vëren se në kërkesë nuk kishte asgjë që do të sugjeronte se gjykatat e rregullta kishin gjykuar parashtruesin e kërkesës përtej parashkrimit, apo se i kishin dorëzuar atij vendimin në mënyrë të paligjshme.

27. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës pretendon që i është shkelur e drejta e tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, pa ofruar ndonjë dëshmi *prima facie* që do mbështeste pohimet e tij.
28. Për më tepër, Gjykata vëren se ekziston dallim ndërmjet gjykimit të drejtë dhe atij të përkryer dhe Gjykatës i është i ditur fakti se gjatë rrjedhës së procedurës së rregullt gjyqësore, qoftë ajo penale apo civile, mund të ndodhin gabime procedurale. Megjithatë, kjo nuk nënkupton automatikisht se parashtruesit potencial të kërkesës i është rrezikuar e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm. Kjo, thjesht, nënkupton se parashtruesve të mundshëm u është mohuar e drejta për gjykim të përkryer dhe, vetvetiu, kjo nuk është e njëjtë me shkeljen e të drejtave elementare.
29. Gjykata Kushtetuese nuk është gjykatë e gjetjes së fakteve. Gjykata Kushtetuese rritet se konstatimi i gjendjes faktike, i drejtë dhe i plotë, është juridiksion i plotë i gjykatave të rregullta dhe se roli i saj është vetëm të sigurojë pajtueshmëri me të drejtat që garantohen me Kushtetutë dhe me instrumente të tjera ligjore. Prandaj, Gjykata Kushtetuese nuk mund të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt (*Shih, mutatis mutandis, i. a., Akdivar kundër Turqisë, 16 shtator 1996, R.J.D, 1996-IV, par. 65*).
30. Gjykata konsideron se kërkesa nuk tregon si dhe pse kanë vepruar në mënyrë arbitrare apo të padrejtë gjykatat e rregullta. Nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të zëvendësojë vlerësimin e saj të fakteve me ato të gjykatave të rregullta. Si rregull i përgjithshëm, është detyrë e këtyre gjykatave të vlerësojnë dëshmitë para vetes. Detyrë e Gjykatës Kushtetuese është të vërtetojë nëse procedurat në gjykatat e rregullta kanë qenë të drejta në tërësinë e tyre, përfshirë edhe mënyrën se si janë marrë dëshmitë (*Shih Aktgjykimin e GJEDNJ-së, Kërkesa Nr. 13071/87, Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar, paragrafi 3, të 10 korrikut 1991*).
31. Fakti se parashtruesit janë të pakënaqur me rezultatin e rastit, nuk mund t'iu shërbejë atyre si bazë që të ngrenë një kërkesë të argumentueshme për shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës (*Shih, mutatis mutandis Aktgjykim i GJEDNJ-së, Kërkesa Nr. 5503/02, MezturTiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005*).
32. Sa i përket kërkesës së parashtruesit për vendosjen e Masës së përkohshme, Gjykata konsideron se një kërkesë e tillë nuk i përmbush kriteret e përcaktuara me nenin 116.2 të Kushtetutës, me nenin 27 të Ligjit dhe me nenin 54 të Rregullores së punës, çka do të shtynte Gjykatën që të vendosë Masën e përkohshme; prandaj, refuzohet kërkesa për Masë të përkohshme.
33. Sa i përket kërkesës së parashtruesit për moszbulim të identitetit të tij, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk ka ofruar prova që do të mbështesnin miratimin e një kërkesë të tillë, dhe as që ka e ka arsyetuar atë, prandaj Gjykata refuzon kërkesën e parashtruesit për moszbulim të identitetit.
34. Rrjedhimisht, kërkesa është qartazi e pabazuar dhe, si e tillë, duhet të hedhet poshtë si e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 dhe me 116.2 të Kushtetutës; në pajtim me nenin 20 e me nenin 27 të Ligjit; dhe në pajtim me rregullin 36.1 (c) e me rregullin 54 të Rregullores së punës, më 10 qershor 2013, njëzëri

VENDOSI

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. TA HEDHË POSHTË kërkesën për Masë të përkohshme;
- III. TA HEDHË POSHTË kërkesën për moszbulim të identitetit;
- IV. Ky vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Ivan Čukalović



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Prof. dr. Enver Hasani